



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 044

MATEMATIKA DHE MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS (KLASAT 6-9)

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Programi “Matematika dhe mësimdhënia e matematikës (klasat 6-9)” është rezultat i bashkëpunimit në mes të Qendrës për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapacitetit në Sektorin e Arsimit Bazik në Kosovë (CDBE), të cilin e zbaton GIZ në partneritet me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT).

Komponenta 2 e këtij Projekti – “Ndërtimi i sistemit të qëndrueshëm për trajnimin e mësimdhënësve dhe trajnim në shërbim” – i kontribuon kualifikimit të mësimdhënësve përmes zhvillimit të programeve të trajnimit në shërbim, që duhet të akreditohen nga MASHT, në përputhje me legjislacionin në Kosovë. Ideja fillestare është të punohet në gjashtë komuna pilot: Fushë-Kosovë, Gjilan, Kaçanik dhe Klinë, ndërsa, në masë më të vogël, me komunat Prizren dhe Prishtinë.

GIZ angazhoi KEC-in, si partner lokal, për të zhvilluar programin e trajnimit dhe e ndihmoi procesin me ekspertizë ndërkombëtare. Në zhvillim e programit janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i ekspertëve vendorë, por edhe i mësimdhënësve që kanë artikulluar nevojat e tyre përmes pjesëmarrjes në procesin konsultativ.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zbatojnë në klasat e tyre metoda, teknika dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit, të cilat lehtësojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve të parapara në Kornizën e Kurrikulit dhe rezultatet e të nxënit në lëndën e matematikës.
- Të përdorin aktivitete të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të koncepteve, rregullave dhe procedurave për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në këtë lëndë.

- Të përshtasin mësimdhënien e tyre nevojave dhe mundësive të nxënësve, të bëjnë diferencimin e mësimdhënies përmes planifikimit të aktiviteteve për të gjithë nxënësit. Të ndihmojnë nxënësit në përvetësimin e qasjes së të nxënësve të vetë-iniciuar.
- Të konkretizojnë nocionet matematikore me shembuj nga jeta praktike duke mishëruar idenë se matematika ka zbatim të jashtëzakonshëm në jetën reale.
- Të përdorë teknologjinë si një “vegël” të rëndësishme të mësimdhënies dhe të nxënësve. Të aftësojnë nxënësit në hulumtimin e informacioneve të ndryshme në internet, të cilat ndihmojnë të nxënësve të koncepteve matematikore dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në këtë lëndë.
- Të përdorin forma të ndryshme të vlerësimit të të nxënësve, të cilat ndihmojnë vlerësimin objektiv të njohurive dhe kompetencave të përfituara nga ata.

Përmbajtja

- 1. Matematika dhe mësimdhënia e matematikës.** – Matematika në Kornizën e Kurrikulit. Mësimdhënia e suksesshme. Përgatitja e orës mësimore. Rezultatet e të nxënësve. Një strukturë për mësimdhënien dhe të nxënësve: Evokimi, Realizimi i kuptimit dhe Reflektimi (ERR). Mësimi model nga aritmetika dhe gjeometria për klasën e VI. Mësimi model me tema interesante, të cilat sfidojnë mësimdhënësit në lidhjen e koncepteve matematikore me dukuri nga jeta praktike. Planifikimi në grupe i një mësimi model për zbatim në klasë dhe diskutimi i tij.
- 2. Mësimdhënia dhe të nxënësve.** – Aktivitetet dhe procedurat e mësimdhënies dhe të nxënësve. Të nxënësve aktiv. Stilet e të nxënësve. Pyetjet, detyrat dhe problemet matematikore. Mësimi model nga algjebra, gjeometria dhe probabiliteti për klasat VII dhe VIII. Mësimi model me tema interesante, të cilat sfidojnë mësimdhënësit në lidhjen e koncepteve matematikore me dukuri nga jeta praktike. Planifikimi individual i një mësimi model për zbatim në klasë dhe diskutimi i tij.
- 3. Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve.** – Format e ndryshme të vlerësimit. Testi – Instrument vlerësimi. Matrica e testit. Këshilla për mësimdhënësin për të inkurajuar nxënësit për të mësuar lëndën e matematikës. Mësimi model nga algjebra dhe gjeometria për klasën e IX. Planifikimi në grupe i një testi për zbatim në klasë dhe diskutimi i tij.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet mësimdhënësve të Matematikës në shkollat e mesme të ulta (klasat 6-9), por nga i njëjti mund të përfitojnë edhe mësimdhënësit e shkencave të natyrës që kanë interesim për të avancuar të kuptuarit e koncepteve matematikore në këtë nivel të shkollimit. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për mësimdhënësit e ardhshëm.

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi organizohet në formë të 3 seminareve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një periudhe 3-4 mujore. Koha në mes të mbajtjes së dy seminareve duhet të jetë së paku një muaj. Çdo seminar ka 16 orë trajnim. Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 25-30.

Gjatë kohës së trajnimit organizohet një monitorim në klasë të secilit pjesëmarrës dhe 3 takime gjysmë ditore me qëllim të këmbimit të përvojave në mes të pjesëmarrësve. Takimet gjysmë ditore mbahen pas çdo seminari 2-ditor. Pas monitorimit të pjesëmarrësve organizohet një takim i veçantë i monitoruesit me mësuesin në të cilin do të diskutohen orët e monitoruara me theks të veçantë në shqyrtimin e përparësive të vërejtura dhe gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e pengesave të paraqitura.

Programi ka gjithsej **60 orë**.

Vlerësimi/Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 80 %, vlerësimi pozitiv i orës mësimore të monitoruar, përgatitja e dosjes dhe pjesëmarrja në takimet gjysmë ditore.

Materialet e trajnimit

Melinda Mula dhe Joachim Schroeder: *Matematika dhe mësuesit e matematikës, udhëzues për klasat 6-9*, KEC & GIZ, Prishtinë, 2011.